



Prishtinë, 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_105\_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 15 të Licencës Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
3. Kërkesën për aprovimin e **Standardeve të Sigurisë së Operimit** të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të KOSTT SH.A. të dërguar me date 14 prill 2008, **në seancën e mbajtur me date 24 qershor 2008, nxori këtë:**

## VENDIM

- I. **Aprovohen Standardet e Sigurisë së Operimit** të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të KOSTT SH.A.
  1. Në prill të vitit 2008 KOSTT-i ka ushtruar kërkesën për aprovimin e Standardeve të Sigurisë së Operimit.
  2. ZRRE ka shqyrtuar dokumentin në fjalë, dhe pas vlerësimit dhe plotësimit të të njëjtit ka aprovuar atë.
  3. Nga data e pranimit të këtij vendimi apo publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KOSTT-i do të publikojë menjëherë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Standardeve të Sigurisë së Operimit.
  4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
  5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e aprovimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
  6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



**Bashkangjitur:** Versionet e aprovuara të Standardeve të Sigurisë së Operimit të KOSTT SH.A. Në rast të mospërputhshmërisë, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze në të cilin është punuar versioni origjinal i këtij dokumenti.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar